



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MARRËVESHJE

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Sot, më datë, 14.04.2017, Palët e mëposhtme:

Këshilli Kombëtar i Territorit, përfaqësuar nga Kryeministri dhe Kryetari i KKT
Z. Edi Rama

dhe

Bashkia Tiranë, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Erion Veliaj

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 14/1, pika 2, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjit Nr. 115/2014, datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” dhe Lejes Zhvillimore të miratuar me Vendimin e KKT-së Nr.06, datë 14.04.2017, për objektin: “Godinë Polifunkionale DTA (DownTown Albania)”, me vendndodhje në Bulevardin “Bajram Curri”, bien dakord si më poshtë:

NENI 1 OBJEKTI

- 1.1 Objekti i kësaj marrëveshje është delegimi i kompetencave Bashkisë Tiranë për kryerjen e procedurave përkatëse ligjore, në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, në lidhje me ndërtimin e objektit: “*Godinë Polifunkionale DTA (DownTown Albania)*”, me vendndodhje në Bulevardin “*Bajram Curri*”, Bashkia Tiranë me zhvillues shoqërorin “DT1” sh.p.k, sipas Lejes Zhvillimore përkatëse, të miratuar me vendimin e KKT-së Nr. 06, datë 14.04.2017.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

NENI 2
KOHËZGJATJA

- 2.1 Kompetencat objekt i kësaj Marrëveshjeje do të ushtrohen nga Bashkia Tiranë, nga data e paraqitjes së aplikimit fillestar të subjektit zhvillues për Leje Ndërtimi, deri në datën e lëshimit të Çertifikatës së Përdorimit.

NENI 3
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

- 3.1 Këshilli Kombëtar i Territorit ka të drejtat dhe detyrimet si më poshtë:
- i. Vënien në dispozicion të Bashkisë Tiranë të Lejes së Zhvillimit të miratuar me vendimin e KKT-së Nr. 06, datë 14.04.2017, për objektin: *“Godinë Polifunkionale DTA (DownTown Albania)”*, me vendndodhje në Bulevardin *“Bajram Curri”*, Bashkia Tiranë.
 - ii. Hartën e Planvendosjes së Strukturave
dhe
 - iii. Dokumentin e Rregullores së Veçantë që shoqëron këtë Vendim.
- 3.2 Bashkia Tiranë ka të drejtat dhe detyrimet si më poshtë:
- i. Kryerjen e të gjitha procedurave administrative/ligjore, sipas përcaktimeve të parashikuara në dispozitat e Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 *“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”*, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”*, i ndryshuar, për objektin: *“Godinë Polifunkionale DTA (DownTown Albania)”*, me vendndodhje në Bulevardin *“Bajram Curri”*, Bashkia Tiranë me zhvillues shoqërinë *“DT1” sh.p.k;*
 - ii. Shqyrtimin e dokumentacionit përkatës tekniko-ligjor, miratimin dhe lëshimin e akteve/dokumenteve të poshtëshënuara, për objektin: *“Godinë Polifunkionale DTA (DownTown Albania)”*, me vendndodhje në Bulevardin *“Bajram Curri”*, Bashkia Tiranë me zhvillues shoqërinë





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

“DT1” sh.p.k, sipas Lejes Zhvillimore përkatëse, të miratuar me vendimin e KKT-së Nr. 06, datë 14.04.2017:

- Leje Ndërtimi;
- Certifikatë Përdorimi.

NENI 4

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 4.1 Palët do t'i zgjidhin të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje me mirëkuptim ndërmjet tyre.

NENI 5

GJUHA E MARRËVESHJES

- 5.1 Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën Shqipe me vlerë të njëjtë.

NENI 6

EFEKTET JURIDIKE DHE PUBLIKIMI

- 6.1 Palët bien dakord se efektet juridike të kësaj Marrëveshjeje do të fillojnë në momentin e nënshkrimit të saj.
- 6.2 Kjo Marrëveshje publikohet në Fletoren Zyrtare.

PALËT

KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

Përfaqësuar nga,
Z. EDI RAMA



BASHKIA TIRANË

Përfaqësuar nga,
Z. ERION VELIAJ

